

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

Pml.Kzz 98/2014

(P. Nr. 592/2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë)

(PAKR 102/2013 Gjykata e Apelit)

Data:

3 shtator 2014

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Timo Vuojolahti (kryetar i kolegjit dhe gjyqtar raportues), dhe gjyqtarit të EULEX-it Willem Brouwer dhe gjyqtares së Gjykatës Supreme Emine Mustafa si anëtarë të kolegjit, me ndihmën e zyrtares ligjore të EULEX-it Kerry Kirsten Moyes në cilësi të procesmbajtëses, në lëndën penale me numër P. Nr. 592/2011 të (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë kundër:

S. A., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për veprë penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LP KSAK) në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

D. H., i lindur më [redacted] në Prishtinë, i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për veprë penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, i dënuar me shtatë (7) vjet burgim;

B. S., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për veprë penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të KPK-së, i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

S. S., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës për veprë penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të KPK-së, i dënuar me shtatë (7) vjet burgim;



dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, i dënuar me tetë (8) vjet burgim;

S [redacted] U [redacted] lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së, në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të KPK-së, për vepër penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, dhe i dënuar me dënim unik me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim;

duke vepruar sipas Kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës N [redacted] Q [redacted] më 30 prill 2014 në emër të të pandehurit S [redacted] A [redacted] nga avokati mbrojtës R [redacted] K [redacted] më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit D [redacted] H [redacted], nga avokati mbrojtës A [redacted] B [redacted] më 15 maj 2014 në emër të të pandehurit B [redacted] S [redacted], nga avokati mbrojtës H [redacted] M [redacted] më 11 qershor 2014 në emër të të pandehurit S [redacted] S [redacted] nga avokatët mbrojtës F [redacted] G [redacted] B [redacted] dhe B [redacted] J [redacted] më 2 qershor 2014 në emër të të pandehurit S [redacted] U [redacted] kundër aktgjyimit të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në këtë lëndë më datë 17 dhjetor 2012 dhe kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të datës 12 dhjetor 2013;

duke marrë parasysh Përgjigjet e Prokurorit të Shtetit KMLP. II. – ZZZK. II. Nr. 70/14 ndaj kërkesave për mbrojtje të lirshmërisë, të paraqitura për S [redacted] A [redacted] më 16 maj 2014, për D [redacted] H [redacted] më 12 qershor 2014, për B [redacted] S [redacted] më 4 qershor 2014, për S [redacted] S [redacted] më 18 korrik 2014, dhe për S [redacted] U [redacted] më 9 qershor 2014;

pas mbajtjes së këshillimit të votimit më 3 shtator 2014

në përputhje me nenin 418 dhe nenet 432-441 të Kodit të Procedurës Penale (KPK)

lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës N Q në emër të të pandehurit S A nga avokati mbrojtës R K në emër të të pandehurit D H nga avokati mbrojtës A B në emër të të pandehurit B S nga avokati mbrojtës H M në emër të të pandehurit S S nga avokatët mbrojtës F G B dhe B J në emër të të pandehurit S U, kundër aktgjykimit të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës të datës 17 dhjetor 2012, dhe kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 12 dhjetor 2013, refuzohen si të pabazuara.

ARSYETIMI

1. Historia e procedurës

1.1. Më 29 korrik 2011 është ngritur aktakuza PPS 460/09, kurse është ndryshuar më 15 shtator 2011, dhe është konfirmuar më 6 tetor 2011.

1.2. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 3 shkurt 2012 dhe përfundoi më 14 dhjetor 2012. Më 17 dhjetor 2012 Gjykata e Qarkut shpalli aktgjykimin dhe të pandehurit i dënoi siç përmendet më lart. Gjykata e Qarkut e ndryshoi cilësimin juridik të pikës 2 të aktakuzës prej veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë (të gjithë të pandehurit përveç S S u akuzuan për këtë veprë penale) në veprën penale të rrëmbimit nga neni 164 (1) i KPRSFJ-së në lidhje me nenet 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 159 (1) të KPK-së në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK-së. Gjykata e Qarkut e refuzoi akuzën për shkak të skadimit të periudhës së parashkrimit.

1.3. Të pesë të pandehurit kanë paraqitur ankesa. Gjykata e Apelit me aktgjykimin e saj të datës 12 dhjetor 2013, e ndryshoi sipas detyrës zyrtare aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut sa i përket cilësimit juridik të veprave penale siç specifikohet më lart. Gjykata e Apelit po ashtu e ndryshoi pjesërisht aktgjykimin mbi ankesat e D H B S dhe S S, kurse sa i përket S A dhe S U sipas detyrës zyrtare e ndryshoi aktgjykimin me qëllim që në dënimin e tyre të përfshihet koha e kaluar në paraburgim. Të gjitha bazat e ankesave të të pandehurve janë refuzuar si të pabazuara.

1.4. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur nga avokati mbrojtës N Q më 30 prill 2014 në emër të të pandehurit S A nga avokati mbrojtës R K më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit D H nga avokati mbrojtës A B më 15 maj 2014 në emër të të pandehurit B S nga avokati mbrojtës H M më 11 qershor 2014 në emër të të pandehurit S S nga avokatët mbrojtës F G B dhe B J më 2 qershor 2014 në emër të të pandehurit S U. Më 16 maj 2014 Prokurori i Shtetit ka paraqitur përfaqësoreshë lidhur me kërkesën e S A më 12 qershor 2014 lidhur me kërkesën e D H më 4 qershor 2014 lidhur me kërkesën e B S më 18 qershor 2014 lidhur me kërkesën e S S dhe më 9 qershor 2014 lidhur me kërkesën e S U.



U [REDACTED] Të gjitha kërkesat janë me afat.

2. Parashtrësit e palëve

2.1. Avokati mbrojtës N [REDACTED] Q [REDACTED] në emër të të pandehurit S [REDACTED] A [REDACTED] Në kërkesë pretendohet se ka shkelje esenciale dhe shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, dhe shkelje të kodit penal në dëm të të akuzuarit.

a. Shkeljet e dispozitave të nenit 403 (1), pika 12 e KPPK-së

- aktgjykimi i shkallës së parë është i paqartë dhe i pakuptueshëm, dhe arsyetimi është kundërthënës dhe konfuz.
- dëshmitari bashkëpunues është mendërisht i sëmurë dhe është duke gënjyer.

b. Shkeljet e nenit 157 (4) të KPPK-së

- Aktgjykimi kryesisht mbështetet në një dëshmi të dëshmitarit bashkëpunues. Fajësimi i S [REDACTED] A [REDACTED] nuk mbështetet me prova të tjera.
- Dëshmitarët M [REDACTED] J [REDACTED] dhe S [REDACTED] T [REDACTED] të cilët kanë dosje penale, kanë dhënë prova të rreme pas marrëveshjes së fshehtë me dëshmitarin bashkëpunues.
- Dëshmitarët e tjerë të Prokurorisë nuk ofrojnë asnjë fakt në lidhje me përfshirjen e S [REDACTED] A [REDACTED] në veprat penale.

c. Shkeljet e nenit 3 (2) të KPPK-së

- Gjykata e shkallës së parë ka shkelur parimin *in dubio pro reo*. Ka pasur dyshime sa i përket provave të dëshmitarit bashkëpunues, të cilat është dashur të interpretohen në dobi të pandehurit.
- I pandehuri ka ofruar alibinë.

d. Shkeljet e nenit 387 (1) dhe (2) të KPPK-së

- Arsyetimi i aktgjykimit në lidhje me dëshmitarin bashkëpunues është një vlerësim subjektiv i gjykatës.
- Gjykata nuk ka vlerësuar me ndërgjegje secilën provë në mënyrë individuale, veçanërisht deklaratat e mëhershme të dëshmitarit bashkëpunues të cilat kundërshtojnë provat e dhëna në gjykatë.
- Gjykata ka refuzuar kërkesën e mbrojtjes për ekzaminimin e gjendjes mendore të dëshmitarit bashkëpunues.

e. Shkeljet e nenit 396 (7) të KPPK-së

- Gjykata ka paraqitur faktet dhe gjetjet e saj në kundërshtim me provat e paraqitura në gjykim, të cilat nuk kanë vërtetuar përgjegjësinë penale të të akuzuarit.

- Gjykata nuk ka ofruar arsyet për refuzimin e kërkesave të mbrojtjes.
- Gjykata nuk ka vendosur se cili ligj është më i favorshëm për të akuzuarin.
- Gjykata ka zbatuar dispozitat e ligjit KPKSAK-së, KPRSFJ-së dhe të KPK-së, të cilat nuk janë më të favorshmet për të akuzuarin.

f. Shkeljet e nenit 1 (2) dhe nenit 5 (1) të KPPK-së

- Aktgjykimi është i ndikuar politikisht, dhe i ndikuar nga opinionimi publik.
- Gjykata është paragjykuar nga bindja e saj se i pandehuri ka qenë pjesëtar i SHIK-ut.
- I pandehuri nuk ka pasur gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

g. Shkeljet e nenit 7 (1) të KPPK-së

- Gjykata nuk ka pranuar alibinë e dhënë nga i pandehuri.
- Gjykata nuk ka vlerësuar faktet dhe provat shfajësuese për të pandehurin, por ka vërtetuar provat e dyshimta.

h. Shkeljet e ligjit penal

- Cilësimi juridik i veprave penale është në kundërshtim me praktikën ligjore.
- Nuk ka qenë korrekte për trupin gjykues që në një lëndë të kombinojë tre (3) ligje në kombinim juridik.
- Paragrafi (2) i nenit 30 të KPKSAK-së përcakton vetëm sanksionet penale dhe jo treguesit kryesorë të veprës.
- Nuk ka pasur arsyetim për cilësimin juridik të nenit 147 (3) dhe (5) të KPK-së.

i. Shkeljet e Gjykatës së Apelit

- Gjykata e Apelit ka shkel kodin penal pasi që nuk i ka përmendur dhe eliminuar shkeljet e gjykatës së shkallës së parë.
- Vrasja nuk mund të kategorizohet si vrasje e rëndë sipas nenit 147 (3) dhe (5) pasi që kjo mund të ekzistojë vetëm kur dhuna kundër viktimës i ka shkaktuar vuajtje apo dhimbje të rëndë fizike. Në këtë rast, vrasja ka qenë pa paralajmërim dhe pa përdorim të dhunës fizike, dhe vrasje nga e shtëna me armë të zjarrit nuk mund të cilësohet si akt i pamëshirshëm apo akt i dhunshëm i pamëshirshëm.
- Në mënyrë që vrasje të cilësohet dinake, ajo patjetër duhet të jetë skajshmërisht dinake, apo duhet të ekzistojë besimi në mes të kryerësit dhe viktimës, apo përdorim të mjeteve të pazakonta. Shtënia mbi viktimën në hyrje të shtëpisë së tij nuk mund të konsiderohet si vrasje dinake.
- Në seancën e Gjykatës së Apelit më 12 dhjetor 2013, avokati mbrojtës ka dorëzuar prova materiale sipas nenit 413 (4), por këto prova nuk janë vlerësuar dhe nuk janë përmendur në aktgjykimin e saj.



Avokati mbrojtës për S [REDACTED] A [REDACTED] i propozon Gjykatës Supreme që kërkesën e tij ta aprovojë si të bazuar, që t'i anulojë të dy aktgjykimet, dhe lëndën ta kthejë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Ai gjithashtu propozon që ekzekutimi i dënimit të shtyhet sipas nenit 454 (4) të KPPK-së.

2.2. Avokati mbrojtës R [REDACTED] K [REDACTED] në emër të D [REDACTED] H [REDACTED] Në kërkesë thekson se të dy aktgjykimet kanë shkelë dispozitat e nenit 384 të Kodit të Procedurës Penale, dhe kanë shkelë Kodin Penale sipas nenit 385 (1) të KPPK-së.

a. Shkeljet e Kodit të Procedurës Penale

- Ekzistojnë kundërthënie në mes të dispozitivit të aktgjykimeve dhe arsyetimeve të tyre.
- Arsyetimet nuk përmbajnë fakte të veprës penale për të cilën D [REDACTED] H [REDACTED] akuzohet.
- Nuk ka asnjë provë të besueshme për të mbështetur fajësimin e tij, vetëm dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues.
- Gjykata në mënyrë të gabuar ka mbështetur pretendimin se A [REDACTED] S [REDACTED] ka vepruar në vetëmbrojtje. Kjo është dashur të përcaktohet vetëm me një procedurë tjetër.

b. Shkeljet e Ligjit Penal

- Ekziston një mungesë totale e provave në lidhje me rolin dhe pjesëmarrjen e D [REDACTED] H [REDACTED] në veprën penale.

Ai i propozon Gjykatës Supreme qa ta aprovojë kërkesën e tij si të bazuar dhe lëndën ta kthejë në rigjykim dhe ri-vendosje.

2.3. Avokati mbrojtës në emër të B [REDACTED] S [REDACTED] Kërkesa thekson se të dy aktgjykimet janë në shkelje të nenit 403 të KPPK-së, dhe në shkelje të Ligjit Penal sipas nenit 404 të KPPK-së.

a. Shkeljet substanciale të nenit 403 të KPPK-së

- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është në shkelje të nenit 403 (1) pikës 12 të KPPK-së sepse; dispozitivi është i pakuptueshëm, kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij dhe bazohet në prova selektive; dëshmitarëve u mungon kredibiliteti, posaçërisht dëshmitarit bashkëpunues; dispozitivi dhe arsyetimi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut janë në mospërputhje me njërin tjetrin sa i përket cilësimit juridik të veprës në Pikën 1. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është gjithashtu në shkelje të nenit 403 (1) pikës 12 të KPPK-së pasi që dispozitivi është i paqartë, kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij pasi që nuk është e qartë se çfarë është ndryshuar. Gjithashtu, Gjykata e Apelit ka përfunduar se ka pasur shkelje të

nenit 159 të KPPK-së kur K [REDACTED] V [REDACTED] është marrë në pyetje pa lejen e organit kompetent, por kjo nuk është konsideruar si shkelje substanciale.

- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ka bërë shkelje substanciale të nenit 403 (1) pikës 8 në lidhje me nenin 157 (4) të KPPK-së pasi që është mbështetur vetëm në një dëshmitar bashkëpunues dhe në asnjë provë tjetër.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut ka bërë shkelje substanciale të nenit 403 (2) pikës 1 pasi që ka marrë në pyetje një dëshmitar të privilegjuar pa lejen e organit kompetent.

b. Shkeljet e nenit 404 të KPPK-së

- Cilësimi juridik i Pikës 1 është në kundërtënie me parimin e ligjshmërisë pasi që ekzistojnë kundërtënie në mes të arsytimit dhe dispozitivit sa i përket cilësimit juridik.
- Gjykata ka bërë shkelje të nenit 404 (1) pikës 5 të KPPK-së në vendimin e saj mbi dënimin duke e konsideruar si rrethanë rënduese se kanë qenë “një grup i organizuar mirë”. Ky cilësim është si ‘Krim i organizuar’ i cili tejkalon kompetencat ligjore të saj.
- Gjykata e Qarkut ka shkelur nenin 404 (1) pikën 6 të KPPK-së sepse nuk e ka llogaritur periudhën e arrestit shtëpiak prej 26 korrikut 2011.
- Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është në shkelje të nenit 404 (1) pikës 6 të KPPK-së sepse nuk përcakton saktësisht kohën e kaluar në paraburgim e cila duhet të llogaritet. Është detyrë ose e Gjykatës së Qarkut ose e Gjykatës së Apelit që ta bëjë llogaritjen e kësaj periudhe.

Ai propozon që aktgjykimet të ndryshohen duke e liruar të pandehurin, ose të anulohen dhe lënda të kthehet për rigjykim në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

2.4. Avokati mbrojtës H [REDACTED] M [REDACTED] në emër të S [REDACTED] S [REDACTED] Në kërkesë thekson se ka pasur shkelje esenciale të nenit 403 (1) të Kodit të Procedurës Penale dhe shkelje të ligjit penal nenit 404 (1).

a. Shkelja esenciale e nenit 403 të KPPK-së

- Dispozitivi i aktgjykimet është i pakuptueshëm, kundërtënes në vetvete dhe arsytimi bazohet në provat e vetëm një personi pa mbështetjen e provave tjera në shkelje të nenit 157 (1) të KPPK-së.
- Provat e dëshmitarit bashkëpunues nuk janë të besueshme, dhe kanë kundërtënie dhe mospërputhje.
- Gjykata ka lejuar marrjen në pyetje të një dëshmitari të privilegjuar pa lejen e organit kompetent.
- Dëshmitari i privilegjuar ka dorëzuar emrin e dëshmitarit të cilin mbrojtja ka lejuar që të ftohet, por kjo është refuzuar nga gjykata.
- Dëshmitarit bashkëpunues nuk është dashur t’i jepet statusi dëshmitari bashkëpunues në këtë rast pasi që ai ka probleme mendore, është përfshirë në aktivitetet kriminale,



ka personalitet të dobët, ka borxhe, dhe është zhytur në probleme afariste.

b. Shkeljet e Ligjit Penal, nenit 404 (1)

- Cilësimi juridik i Pikës 3 shkel ligjin penal pasi që ai dënohet për të dyja Vrasje në tentativë dhe Vrasje e rëndë në tentativë, e ku do të duhet të ishte ose njëra ose tjetra.
- Gjykata gabimisht ka vlerësuar se vepra penale ka karakteristika të një 'grupi të organizuar mirë' si veti rënduese, dhe prandaj ka cilësuar si Krim të organizuar, e që tejkalon kompetencat e saj duke e tejkuluar aktakuzën.
- Gjykata nuk ka përfshirë kohën e kaluar në arrest shtëpiak prej 21 korrikut 2011 në llogaritjen e dënimit.
- Tetë (8) vite burgim është një dënim tepër i rëndë.

Ai propozon që i pandehuri të lirohet, ose që lënda të kthehet në rigjykim.

2.5 Avokatët mbrojtës F [redacted] G [redacted] B [redacted] dhe B [redacted] J [redacted] në emër të S [redacted]

U [redacted] Në kërkesë theksojnë se të dy aktgjykimet kanë bërë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384, dhe shkelje të ligjit penal sipas nenit 385 (1) të KPPK-së.

a. Shkeljet e procedurës penale sipas nenit 483 të KPPK-së

- Të dy aktgjykimet janë të pakuptueshme dhe në kundërtënie me vetveten. Nuk janë përfshirë faktet thelbësore, dhe ato të cilat janë paraqitur janë të paqarta dhe kundërtënëse.
- Të dy aktgjykimet janë mbështetur në prova të papranueshme, pasi që shpallja fajtor e të pandehurit është bazuar vetëm në provat e dëshmitarit bashkëpunues, në kundërshtim me nenin 157 (4) të KPPK-së. Asnjë dëshmitar tjetër nuk ka vërtetuar deklaratat e tij.
- Dëshmitarët Syleman Tershani dhe Metush Isufaj nuk janë të besueshëm.
- Avokati mbrojtës ka kërkuar që Gjykata e Qarkut t'ia mundësoj ekzaminimin neuropsikiatrik të dëshmitarit bashkëpunues, mirëpo kjo është refuzuar. Ai gjithashtu është i zhytur thellë në borxhe, është përfshirë në mashtrime dhe kundër tij është duke u zhvilluar procedurë penale. Personaliteti i tij është dashur të vlerësohet, si dhe marrëdhëniet e tij me anëtarët e familjes së tij është dashur të vlerësohen.

b. Shkeljet e ligjit penal sipas nenit 385 të KPPK-së

- Shkelja e ligjit penal ekziston për shkak të mospërputhjeve në deklaratën e të vesë së të ndjerit A [redacted] K [redacted] në lidhje me deklaratimet e dëshmitarit bashkëpunues.
- Gëzhojat e plumbave të përdorur për vrasjen e I [redacted] K [redacted] të dhëna nga dëshmitari bashkëpunues i takojnë një lloji tjetër të armës të cilat i takonin gëzhojave të gjetura në vendin e vrasjes.

- Arma e vrasjes nuk është gjetur, dhe në lidhje me këtë janë bërë deklarata kundërthënëse nga dëshmitari bashkëpunues.
- Nuk ekziston asnjë provë për të dënuar të pandehurin, deklaratimet e dëshmitarit bashkëpunues janë produkt i imagjinatës së tij.
- Pika 3 nuk është vërtetuar se ekziston ndonjë pasojë për palën e dëmtuar.
- Dënimi është drastik për këtë vepër sipas praktikës gjyqësore.


Ata propozojnë që kërkesa e tyre të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rigjykim.

2.6. Prokurori i Shtetit

Lidhur me S. A., Prokurori i Shtetit vëren se pretendimet e avokatit mbrojtës janë përsëritje e argumenteve tashmë të ngritura gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në ankesën e tij në shkallë të dytë, dhe janë refuzuar nga të dy gjykatat si të pabazuara. Aktgjykimet e kundërshtuara kanë vlerësuar provat në hollësi dhe kanë dhënë arsyet për rëndësinë që ia kanë kushtuar të gjitha provave. Përndryshe, pretendimet e avokatëve mbrojtës janë në lidhje me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si të tilla nuk mund të ngritën me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Prokurori vëren se përpjekjet e avokatit mbrojtës për të paraqitur prova të reja janë në shkelje të nenit 392 të KPP-së i cili e kufizon mundësinë në 'vetëm kur është e nevojshme' e cila nuk është përmbushur gjatë seancës së apelit. Ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimet të vërtetohen.

Lidhur me D. H. Prokurori i Shtetit thekson se të dy aktgjykimet nuk përmbajnë shkelje të procedurës penale. Kundërshtimet e aktgjyqimeve në baza faktike apo provuese shërbejnë vetëm si një bazë pretendimë të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike sipas nenit 386 (2) dhe (3) të KPP-së (njëjtë sikurse në nenin 405 (2) dhe (3) të KPPK-së. Prokurori i Shtetit i referohet nenit 432 (2) të KPP-së i cili thekson se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kërkesa duhet të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimet të vërtetohen.

Lidhur me B. S. Prokurori i Shtetit thekson se argumentet janë identike me ato të ngritura në ankesën kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut. Ato tashmë janë adresuar dhe refuzuar nga Gjykata e Apelit, përveç llogaritjes së periudhës së paraburgimit. Prokurori pohon se aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përmban asnjë shkelje të procedurës penale. Është më se e qartë nga dispozitivi se referimi i pikës 11 të nenit 147 të KPP-së në Pikat 1 dhe 3 është ndryshuar, dhe po ashtu është e qartë se ky është ndryshimi i vetëm i bërë për cilësimin e veprave penale. Nuk ka asnjë kundërshtim në lidhje me provat e K. V. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në mënyrë të qartë thekson se deklarata e tij nuk e ka ndikuar aktgjykimin. Prokurori i Shtetit pajtohet me



avokatin mbrojtës në lidhje me llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, dhe vetëm gjykata është e autorizuar që ta bëjë këtë. Sidoqoftë, mjete juridik nuk duhet të jetë lirimi i të pandehurit apo anulimi i aktgjykimeve. Kërkesa duhet të pranohet pjesërisht në lidhje me këtë pikë, dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të ndryshohet sipas detyrës zyrtare për katër (4) të pandehurit e tjerë, dhe kërkesa të refuzohet në pjesët e saj mbetura.

Lidhur me S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] Prokurori vëren se është shumë e vështirë që të kuptohen argumentet në kërkesë, siç është vërejtur nga përkthyesi disa paragrafë janë të paqartë ose të pakuptueshëm. Gjithashtu, nuk është gjithmonë e qartë se cilit aktgjykim i referohet. Nga argumentet të cilat mund të kuptohen, shumë prej tyre tashmë janë ngritur. Më tutje, kundërshtimet në lidhje me vlerësimin e provave nuk mund të shërbejnë si bazë për pretendime për shkelje të ligjit të procedurës penale apo ligjit penal siç është përcaktuar në nenet 384 dhe 385 të KPP-së (njëjtë sikurse në nenin 405 (2) dhe (3) të KPPK-së). Neni 432 (2) i KPP-së thekson se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Përndryshe, çdo pretendim për anshmëri është dashur të ngritet më herët dhe të ishte i mbështetur mirë. Çështjet e besueshmërisë dhe dëshmitarit të privilegjuar nuk e kanë ndikuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, e po ashtu as vendimi i gjykatës për të mos ftuar dëshmitarin emrin e të cilit e ka dhënë dëshmitari i privilegjuar. Neni 300 i KPP-së nuk kërkon ekzaminim të përgjithshëm të dëshmitarit bashkëpunues. Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në mënyrë të qartë thekson se cilësimi i veprave për të cilat i pandehuri dënohet – Vrasje e rëndë në tentativë – nuk është në asnjë mënyrë i paqartë. Është po ashtu e qartë se akti nuk është cilësuar si Krim i organizuar, dhe kjo pikë tanimë është trajtuar nga Gjykata e Apelit. Prokurori i Shtetit propozon që aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të ndryshohet sipas detyrës zyrtare për të përfshirë llogaritjen e kohës së kaluar në arrest shtëpiak, dhe të refuzojë kërkesën në pjesët e saj të mbetura.

Lidhur me S [REDAKTUAR] U [REDAKTUAR] avokatët mbrojtës dështojnë që të parashtrajnë argumente specifike për të mbështetur pretendimet e tyre për shkelje të kodit penal. Ata nuk kanë sqaruar se pse i konsiderojnë provat e dëshmitarit bashkëpunues të papranueshme, e as pse provave të S [REDAKTUAR] T [REDAKTUAR] dhe M [REDAKTUAR] i mungon besueshmëria. Gjykata e Qarkut ka analizuar në hollësi kredibilitetin e dëshmitarit bashkëpunues. Kundërshtimet mbi bazat e provimit të aktgjykimeve të kundërshtuara nuk shërbejnë si bazë për shkelje të ligjit penal siç është përcaktuar me nenin 385 të KPP-së (sikur në nenin 404 të KPPK-së). Neni 432 (2) i KPP-së thekson se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Lidhur me Pikën 3, Prokurori pohon se akti nuk ka pasur pasoja, për këtë arsye është cilësuar si Tentativë sipas nenit 19 të KPRSFJ-së. Përfundimisht, avokatët mbrojtës kanë dështuar që të citojnë ndonjë praktikë gjyqësore për të mbështetur pretendimin e tyre se dënimi i të pandehurit është 'drastik'.

3. Kompetencat e kolegjit

Çështja

3.1. Kolegji i Gjykatës Supreme vëren se Ligji nr. 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të bashkimit evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës (tani e tutje si “*Ligji Omnibus*”), i miratuar më 23 prill 2014, ka hyrë në fuqi më 30 maj 2014 dhe *inter alia* ka ndryshuar Ligjin Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (tani e tutje si “*Ligji mbi kompetencat*”). *Ligji Omnibus* ngrit çështjet e kompetencave të gjyqtarëve të EULEX-it dhe përbërjen e kolegjeve që lidhen me kompetencat e gjykatave. Prandaj, kolegji së pari duhet të përcaktojë nëse Gjyqtarët e EULEX-it kanë kompetenca për ta gjykuar këtë lëndë, dhe nëse kanë, çfarë përbërje do të ketë kolegji.

Faktet

3.2. Aktakuza është ngritur më 29 korrik 2011 nga Prokurori i PSRK-si i EULEX-it pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur nga kolegji prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari vendor. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut është shpallur më 17 dhjetor 2012. Ankesat janë dëgjuar në Gjykatën e Apelit nga kolegji i përbërë prej dy Gjyqtarëve të EULEX-it dhe një Gjyqtari vendor. Gjykata e Apelit ka lëshuar aktgjykimin e saj më 12 dhjetor 2013.

3.3. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë janë paraqitur si më lart:

S [REDACTED] A [REDACTED] më 30 prill 2014, B [REDACTED] S [REDACTED] më 15 maj 2014, S [REDACTED] U [REDACTED] më 2 qershor 2014, D [REDACTED] H [REDACTED] më 5 qershor 2014 dhe S [REDACTED] S [REDACTED] më 11 qershor 2014.

3.4. Lënda është regjistruar në shkrimoren e Gjykatës Supreme si Pml.Kzz 98/2014 më 13 maj 2014 pas pranimit të kërkesës së parë për mbrojtje të ligjshmërisë në këtë lëndë (në emër të S [REDACTED] A [REDACTED]).

Ligji

3.5. Neni 3 i *Ligjit omnibus* ka shtuar nenin 1.A dhe ka ndryshuar nenin 3 të *Ligjit mbi kompetencat* si në vijim:

Neni 1.A. Rastet në proces

Për qëllime të këtij ligji rast në proces nënkupton:

1. Rastet për të cilat vendimi për fillimin e hetimeve është dhënë para datës 15 prill 2014 nga prokurorët e EULEX-it në pajtim me ligjin
2. Rastet të cilat u janë caktuar gjyqtarëve të EULEX-it para datës 15 prill



2014.

Neni 3. Juridiksioni dhe kompetencat e gjyqtarëve të EULEX-it për procedurat penale

3.1. Gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në procedurat penale do të kenë juridiksion dhe kompetenca për rastet që janë në proces siç përcaktohet në nenin 1.A nën-paragrafin 1.2 të këtij ligji.

3.2. ...

3.3. Kolegjet në të cilat gjyqtarët e EULEX-it ushtrojnë juridiksionin e tyre në procedurat penale do të përbëhen me shumicë të gjyqtarëve të vendorë dhe do të kryesohen nga një gjyqtar vendorë. Me kërkesën e bazuar të autoritetit kompetent të EULEX-it, Këshilli Gjyqësor i Kosovës do të vendosë që kolegji të përbëhet me shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it..

3.4. ...

3.6. Neni i ndryshuar 2.3 i *Ligjit mbi kompetencat* përcakton se sipas nevojës, aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore do të përcaktohen me tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

3.7. Marrëveshja në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore është arritur më 18 qershor 2014 (tani e tutje 'Marrëveshja').

Vlerësimi

3.8. Nuk ka asnjë dyshim se kërkesat janë paraqitur dhe regjistruar pranë gjykatës (në të dyja Gjykatën Themelore dhe Gjykatën Supreme) pas 15 prillit 2014. Rrjedhimisht, është e qartë se lënda i është caktuar një Gjyqtari të EULEX-it në Gjykatën Supreme pas 15 prillit 2014.

3.9. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është mjet i jashtëzakonshëm juridik që përdoret kundër vendimeve të formës së prerë. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bëhet lëndë në pritje kur paraqitet pranë gjykatës. Kjo e mbështet interpretimin se ky rast i mjetit të jashtëzakonshëm juridik nuk ka qenë rast në proces më 15 prill 2014, dhe prandaj do të ishte jashtë juridiksionit të Gjyqtarëve të EULEX-it.

3.10. Në anën tjetër, çështje thelbësore është se si do të interpretohet shprehja 'rastet të cilat i janë caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it para 15 prillit 2014' në situatat kur 'rasti' i referohet kërkesës për mjete të jashtëzakonshme juridike.

3.11. Kolegji vëren se *Ligji mbi kompetencat* është ndryshuar nga autoritetet kompetente të Kosovës pas një marrëveshje ndërkombëtare të arritur në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë), e ratifikuar me anë të ligjit nr. 04/L-274. 'Shkëmbimi i letrave', pjesë integrale e këtij ligji, përshkruan se tranzicionin i mandatit të EULEX-it në Kosovë bazohet në politikën "jo më raste të reja". Kjo jep arsye që të konstatohet se marrëveshja ndërkombëtare është bazuar në idenë që rastet me të cilat Prokurorët dhe Gjyqtarët e EULEX-it kanë qenë duke u marrë (para 15 prillit 2014) duhet gjithashtu të përfundohen nën juridiksionin e Gjyqtarëve të EULEX-it.

3.12. Neni i ri 1.A në Ligjin mbi kompetencat flet për 'rastet'. Ligji nuk jep ndonjë sqarim të mëtutjeshëm se çfarë nënkuptohet me konceptin e 'rastit'. Sidoqoftë, është mjaft e qartë se 'rasti' i referohet procedurës penale e cila ka të bëjë me një apo më tepër vepra penale. Neni 68 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) sqaron fazat e një procedure penale si në vijim:

Sipas këtij Kodi të Procedurës Penale, procedura penale ka katër faza të ndryshme: fazën e hetimit, fazën e ngritjes së aktakuzës dhe deklarimit, fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe fazën e mjetit juridik.

3.13. Kolegji vëren se kur hetimi të ketë filluar, do të thotë se ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra penale (apo do të kryhet). Vendimi për fillimin e hetimit specifikon *inter alia* të dyshuarin, përshkrimin e aktit i cili specifikon elementet e veprës penale, dhe emrin ligjor të veprës penale. Më vonë, është e mundur që të zgjerohen hetimet. Sidoqoftë, kur hetimi të ketë përfunduar dhe sipas kushteve të përcaktuara me ligj, 'rasti' kalon në fazën e ardhshme (fazën e aktakuzës dhe deklarimit), pastaj në fazën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fund në fazën e mjetit juridik. Por gjatë gjithë kësaj kohe, 'rasti' është i njëjtë; trajtohet të njëjtat fakte relevante të cilat përbëjnë elementet e veprës penale për të cilën i pandehuri është dyshuar, apo për të cilën është akuzuar, apo për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar.

3.14. Titulli i Kapitullit XXI në KPP është "Mjetet juridike". Kapitulli përfshin të dyja mjetet e zakonshme dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

3.15. Kolegji konsideron se koncepti i 'rastit' në nenin 1.A të Ligjit mbi kompetencat duhet patjetër të interpretohet në atë mënyrë që të mbulojë të gjitha fazat e procedurës penale dhe gjithashtu edhe mjetet e jashtëzakonshme juridike. 'Rasti' përmban të njëjtin të pandehur, të njëjtën vepër penale dhe të njëjtat fakte. Nuk bëhet rast i ri thjesht vetëm se hyn në një fazë të re të procedurës penale.

3.16. Është fakt se kërkesa në fjalë ka të bëjë me një procedurë penale në të cilën aktvendimi për fillimin e hetimit është lëshuar nga Prokurori i UELEX-it dhe është kryer gjykuar nga Gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën e Qarkut dhe Gjykatën e Apelit të ortha këto para 15 prillit 2014. Kolegji, me shumicë votash, përfundon se rasti në fjalë,



kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të konsiderohen se rast në proces në kuptimi të nenit 1.A të Ligjit mbi kompetencat. Kjo do të thotë se rasti i takon juridiksionit të Gjyqtarëve të ULEX-it.

3.17. Çështja e ardhshme është përbërja e kolegjit.

3.18. Formulimi në nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat mbështet interpretimin se shumica e në kolegji duhet të përbëhet nga Gjyqtarët vendorë. Sidoqoftë, Pika 2 e Marrëveshjes thotë, *se në të gjitha rastet në proces trupat gjykues të përbërë nga shumica e Gjyqtarëve të EULEX-it do të vazhdojnë me shumicën e Gjyqtarëve të EULEX-it në të gjitha fazat gjyqimit dhe pjesën e mbetur të procedurës.*

3.19. Formulimi i dispozitës është i mjegullt dhe i paqartë. Në njëërën anë, flet për trupat gjykues të cilat konsiderohet se i referohen vetëm gjyqimit në shkallë të parë. Në anën tjetër flet në lidhje me *'të gjitha fazat e gjyqimit dhe pjesën e mbetur të procedurës'* e cila në mënyrë të qartë tregon për të gjitha fazat e gjyqimit dhe procedurës. Kurse Marrëveshja ka pasur për qëllim që të ofrojë udhëzime ('përcaktojë më tutje') për interpretimin e Ligjit omnibus, do të ishte e drejtë të supozohet se do të shprehte qartë duke përdorur koncepte të sakta juridike, qëllimi dhe fushëveprimin e kësaj dispozite.

3.20. Shumica e kolegjit konsideron se me përsëritjen e të njëjtës çështje dy herë duke përdorur shprehje të ndryshme (*'në vazhdim të të gjitha fazave të gjyqimit'* dhe *'pjesën e mbetur të procedurës'*), palët e marrëveshjes kanë theksuar se dispozita ka të bëjë me të gjitha fazat e procedurës penale. Kjo do të thotë se dispozita mbulon gjithashtu edhe fazën e mjeteve juridike. Prandaj, shumica e kolegjit përfundon se dispozita duhet patjetër të interpretohet që të nënkuptoj se *kur kolegji ka qenë i përbërë nga shumica e Gjyqtarëve të EULEX-it, të gjitha fazat vijuese të procedurës gjithashtu do të mund të zhvillohen me shumicë të Gjyqtarëve të EULEX-it.* Ky interpretim është gjithashtu në përputhje me politikën 'jo më raste të reja' siç është përcaktuar në marrëveshjen ndërkombëtare (paragrafin 3.11, më lart). Prandaj, shumica e kolegjit konsideron se procedura në lidhje me gjykimin e rastit në proces nuk është prekur nga ndryshimet që janë në fuqi prej 30 majit 2014.

3.21. Sipas këtij interpretimi, në këtë rast në proces shumica e Gjyqtarëve të EULEX-it është kompetente që ta shqyrtojë kërkesën me Kryetar të kolegjit dhe gjyqtar raportues nga EULEX-i.

4. Gjetjet e kolegjit

A. Gjetjet e përgjithshme

4.1. Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë nga avokatët mbrojtës dhe përgjigjet nga Prokurori i Shtetit janë të pranueshme dhe të paraqitura brenda afatit kohor.

4.2. Një numër i madh pikash është ngritur nga avokatët mbrojtës. Sidoqoftë, Gjykata Supreme vëren se shumica prej tyre janë çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga Gjykata e Qarkut, veçanërisht ato të dëshmitarit bashkëpunues. I përkujtojmë avokatët mbrojtës se kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqitet mbi bazën e shkeljes së ligjit penal, mbi bazën e shkeljes së caktuar substanciale të dispozitave të procedurës penale, apo nëse ekziston ndonjë shkelje tjetër e dispozitave të procedurës penale cila ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor. Kërkesë nuk mund të paraqitet mbi bazën e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike (neni 432 i KPP-së). Gjykata Supreme pajtohet me Prokurorin e Shtetit se përmbajtja e kërkesave janë kryesisht përsëritje e ankesave të tyre kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Fatkeqësisht është një tendencë e përhapur gjerë në mesin e shumë avokatëve mbrojtës që të përdorin kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si ankesë të dytë, gjë që nuk do të duhej të ndodhte.

B. Dispozitivi dhe baza e aktgjykimit

4.3. Në përgjithësi, të gjithë avokatët mbrojtës pretendojnë se të dy aktgjykimet nuk kanë treguar në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye janë konsideruar të jenë të vërteta, apo se janë të pakuptueshme dhe kundërthënëse, ose që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe në mospërputhje me arsyetimin. Shumica e këtyre pretendimeve mund të konsiderohet se formalisht bazohen në nenin 403 (1.12) të KPPK-së.

4.4. Gjykata Supreme tërësisht nuk pajtohet me këto pohime. Aktgjykimi i shkallës së parë është tejet i hollësishëm dhe i qartë sa i përket asaj që saktësisht është gjetur si e vërtetuar – përsëri, kjo është detajuar në mënyrë tërësisht gjithëpërfshirëse. Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është po ashtu i artikuluar në arsyetimin e tij dhe plotësisht i qartë sa i përket gjetjeve të tij. As Gjykata Supreme nuk ka mundur të identifikojë ndonjë kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit në asnjërin aktgjykim.

4.5. Gjykata Supreme jep një kritikë të vogël në dispozitivin e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut. Në dispozitiv, në Pikën 1 të pandehurit S. A. B. S. dhe S. U. janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë (sipas nenit 30 (1) dhe (2) të LPKSAK-së). Në Pikën 3 të pandehurit S. U. D. H. dhe S. S. janë shpallur fajtorë për kryerjen e veprës penale Vrasje e rëndë në tentativë (sipas nenit 30 (1) dhe (2) të LPKSAK-së dhe nenit 19 KPRSFJ-së)¹. Rrethana e cila cilëson veprat penale si të rënda është përshkruar në nën-paragrafin 1 të nenit 30 (2) të

¹ Gjykata e Qarkut gjithashtu ka zbatuar nenin 30 (3) të LPKSAK-së për të pandehurin S. U. duke konsideruar se me kryerjen e këtyre dy veprave penale faktori relevant nën paragrafin 3, cilëson veprat të rënda, është vërtetuar (shih aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, versioni në gjuhën angleze, fletat 3-2 dhe 3. Sidoqoftë, Gjykata e Apelit ka gjetur se kjo ka qenë shkelje e ligjit penal dhe ka konstatuar se paragrafi i nenit 30 nuk ka qenë i zbatueshëm për S. U. (shih aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, versioni në gjuhën angleze, paragrafët 56-60).



LPKSAK-së; *i merr jetën personit tjetër në mënyrë mizore dhe dinake*². Gjykata e Qarkut ka konsideruar se rrethana rënduese korresponduese në Kodin Penal të Kosovës (KPK) që ka qenë në fuqi në kohën e gjykimit është gjetur në nenin 147 (3); ... *në mënyrë mizore apo dinake*.

4.6. Kjo rrethanë rënduese nuk është përmendur në dispozitiv duke përdorur shprehjet në ligj. Sidoqoftë, faktet të cilat sipas Gjykatës së Qarkut kanë vërtetuar rrethanat rënduese duhet të gjenden nga dispozitivi. Në pjesën e arsytimit të aktgjykimit Gjykata e Qarkut ka analizuar drejtë ekzistimin e rrethanave rënduese 'në mënyrë mizore apo tinëzare' (dhe sipas KPK-së 'në mënyrë mizore dhe dinake')³. Gjykata Supreme konsideron se ky defekt i vogël në dispozitiv nuk përbën shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale siç është pretenduar në kërkesa.

4.7. Prandaj, kolegji nuk gjen asnjë shkelje të rregullave të nenit 403 (1) pikës 12 të KPPK-së të pretenduar në kërkesa.

C. Dëshmitari bashkëpunues dhe provat mbështetëse

4.8. Disa nga kërkesat pretendojnë se aktgjykimi është bazuar në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues, dhe nuk janë paraqitur prova mbështetëse.

4.9. Neni 157 paragrafi 4 i KPPK-së përcakton:

Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues.

4.10. Së pari, Gjykata Supreme vëren se pretendimi i njëjtë është ngritur në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit ka theksuar (shih paragrafin 47 të aktgjykimit) se të dy akuzat (pika 1 dhe pika 3) janë vërtetuar nga dëshmitarët e tjerë dhe provat forenzike. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Apelit se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut demonstroi se trupi gjykues ka pasur parasysh dispozitën e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me këtë çështje, dhe ka vlerësuar me kujdes dhe ka paraqitur në detaje se çfarë ka gjetur si provë mbështetëse vërtetuese.

4.11. Çështje e vetëm relevante e mbetur është nëse është dashur të ketë prova të tjera veçanërisht për identitetin e kryerësve. Përkatësisht, nuk ka asnjë dëshmitar tjetër përveç dëshmitarit bashkëpunues i cili ka identifikuar kryerësit.

4.12. Gjykata Supreme thekson se neni 147(4) i KPPK-së nuk përcakton asnjë rregull të mëtutjeshëm për të specifikuar se çfarë lloji i provave tjera vërtetuese kërkohet, apo për cilat elemente apo fakte të lidhura me veprën penale. Prandaj, Gjykata Supreme

² Shih aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, versioni në gjuhën angleze, faqet 22-23 dhe 38.

³ Shih aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut, versioni në gjuhën angleze, faqet 22-23 dhe 38.

konsideron se kjo çështje, nëse janë paraqitur provat të mjaftueshme mbështetëse vërtetuese, duhet të vlerësohet në secilin rast ndaras. Duke e bërë këtë trupi gjykues duhet të ketë parasysh të gjithat provat e paraqitura në lëndë si dhe besueshmërinë e atyre provave. Pra, varësisht nga rasti, nëse dëshmia e dëshmitarit bashkëpunues është gjetur të jetë fuqishëm e besueshme dhe se dëshmia në disa pjesë mbështetet me prova të tjera, mund të mos ketë nevojë që të kërkohen prova vërtetuese mbështetëse për të gjitha faktet tjera relevante, për shembull lidhur me identitetin e kryerësit.

4.13. Gjykata e Qarkut në mënyrë të shteruar ka studiuar besueshmërinë e dëshmitarit bashkëpunues dhe ka gjetur dëshminë e tij të besueshme, kredibile dhe bindëse. Dëshmitari bashkëpunues ka njohur paraprakisht kryerësit e tjerë dhe Gjykata e Qarkut nuk ka gjetur asnjë pasiguri në dëshminë e tij në lidhje me kryerësit e tjerë. Ka prova të tjera të cilat Gjykata e Qarkut ka gjetur se mbështesin disa pjesë të ngjarjeve të përshkuara në dëshminë e dëshmitarit bashkëpunues. Gjykata Supreme pajtohet me Gjykatën e Apelit se të pandehurit nuk janë shpallur fajtorë vetëm në bazë të dëshmisë së dhënë nga dëshmitari bashkëpunues. Fakti se asnjë provë tjetër nuk ka provuar në mënyrë të drejtpërdrejtë identitetin e kryerësve nuk do të thotë se të pandehurit janë shpallur fajtorë vetëm në bazë të dëshmisë së dëshmitarit bashkëpunues.

4.14. Është e qartë se avokatët mbrojtës nuk pajtohen me besueshmërinë dhe peshën e dhënë kësaj prove, por kjo është çështje tërësisht e ndarë nga ajo nëse janë gjetur apo jo prova mbështetëse vërtetuese nga Gjykata e Qarkut. Gjykata Supreme konstaton se kundërshtimet mbi këtë bazë janë pa merita dhe se nuk ka asnjë shkelje të nenit 157 (4) të KPPK-së.

D. Provat e reja në Gjykatën e Apelit

4.15. Avokati mbrojtës N. Q. pohon në kërkesën e paraqitur në emër të pandehurit S. A. se kishte dorëzuar prova të reja në Gjykatën e Apelit. Ai thekson se ka arsyetuar se pse provat nuk ishin dorëzuar me kohë (supozohet se ka dashur të thotë gjatë shqyrtimit gjyqësor) dhe se ato nuk ishin vlerësuar nga Gjykata e Apelit dhe nuk ishin përmendur fare në aktgjykim⁴.

4.16 Neni 411 paragrafi 2 i KPPK-së përcakton:

Gjykata e shkallës së dytë në seancë të kolegjit vendos nëse do ta mbajë shqyrtimin.

4.17. Neni 412 paragrafi 1 i KPPK-së përcakton:

Shqyrtimi para gjykatës së shkallës së dytë mbahet vetëm kur është e nevojshme që, për

⁴ Avokati mbrojtës gjithashtu pohon se janë bashkangjitur 10 dokumente në kërkesën e tij mbrojtëse të ligjshmërisë, por vetëm njëra mund të identifikohet në mesin e letrave.



shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës së shkallës së parë në gjykim të serishëm.

4.18. Nga procesverbali i seancës së Gjykatës së Apelit mund të konstatohet si në vijim:

- Kryetari i kolegjit ka përmbushur formalitetet se, *'të pandehurit dhe palët njoftohen se gjatë kësaj seancë kolegji nuk do të pranojë asnjë provë'*.
- Avokati mbrojtës N. Q. në emër të pandehurit S. A. ka theksuar, *'Dëshiroj ta shfrytëzoj të drejtën time të përcaktuar me dispozitat e nenit 393 par. 4 edhe pse i kam kuptuar nga gjykata udhëzimet e dhëna në fillim të seancës se gjykata nuk do të pranojë prova, sidoqoftë, unë kam përgatitur prova me shkrim të cilat dëshiroj t'i paraqes sot dhe këto prova kanë të bëjnë me dy dëshmitarët e Prokurorisë S. T. dhe M. K.'* Ai ka vazhduar, *'në lidhje me provat që do t'i paraqes sot, unë kam bërë kopje për kolegjin dhe palët dhe tani po ia dorëzoj gjykatës. Dëshmitari M. K. ekziston një kallëzim penal kundër këtij dëshmitari sepse ka dhënë dëshmi të rreme.'*
- Pastaj ai është pyetur nëse kjo [provë] ishte vetëm në gjuhën shqipe, për të cilën ai u përgjigj, po. Avokati mbrojtës vazhdoi me komente në lidhje me substancën e ankesës së tij. Ai pastaj u kthye në temën e provave dhe tha, *'...po i referohem provave të paraqitura sot. Nga këto prova rezulton se dëshmitari M. K. në deklaratën e dhënë në Prokurori dhe në Gjykatë ka deklaruar se S. A. e ka sulmuar atë dhe ka kryer veprën penale vrasje në tentativë kundër tij. Nga këto dokumente që i paraqita dëshiroj të dëshmoj se është e kundërta se dëshmitari është personi i sulmuar në këtë rast. I keni analizat e armës e cila thekson se arma përdorur ka qenë ajo e M. K.'*

4.19. Nga procesverbali i seancës së Gjykatës së Apelit mund të konstatohet se Prokurori nuk ka kërkuar që t'i drejtohet gjykatës në lidhje me çështjen e 'provave të reja', kryetari i kolegjit nuk ka bërë komente të mëtutjeshme në lidhje me dokumentet, e as kolegji nuk ka marrë ndonjë vendim në lidhje me këtë çështje. Më tutje, në procesverbal nuk është detajuar çfarë dokumente, apo sa dokumente avokati mbrojtës po mendohej t'i paraqiste si prova.

4.20. Nuk ka asnjë dyshim se seanca e mbajtur ka qenë seancë e kolegjit e mbajtur në kuptim të neneve 410 dhe 411 të KPPK-së. Prova të reja mund të paraqiten vetëm në shqyrtim të Gjykatës së Apelit (neni 412 dhe 413 i KPPK-së), jo në seancë. Seanca e kolegjit nuk bëhet shqyrtim nëse pala mundohet që të paraqes prova. Gjykata Supreme thekson se kryetari i kolegjit në mënyrë të qartë ka udhëzuar palët se seanca ka qenë seancë e kolegjit dhe se kolegji nuk do të pranojë asnjë provë. Nuk ka asgjë që tregon se dokumentet e paraqitura janë pranuar si pjesë e këtyre shkresave të lëndës. Përkundrazi, kryetari i kolegjit nuk e ka adresuar këtë material fare, nuk është diskutuar në seancë,

nuk i është dhënë palëve të tjera dhe nuk është përmendur në aktgjykim. Nëse avokati mbrojtës ka dashur të kërkojë që Gjykata e Apelit duhet të mbajë shqyrtim në mënyrë që të pranojë prova të reja, ai është dashur ta theksojë këtë në mënyrë të qartë. Me paraqitjen e dokumenteve avokati mbrojtës vetëm ka shkelur dispozitat e ligjit dhe udhëzimet e dhëna nga kryetari i kolegjit dhe ka zgjatur seancën.

4.21. Prandaj, nuk ka shkelje të dispozitave të procedurës penale siç pretendohet në këtë pikë në lidhje me këto dokumente.

E. In dubio pro reo

4.22. Të dy edhe Kodi i vjetër i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) edhe Kodi i ri i Procedurës Penale (KPP), në nenin 3 paragrafin 2, përcaktojnë:

Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal sipas këtij Kodi interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij...

4.23. Është praktikë e zakonshme në mesin e avokatëve mbrojtës që të thirren në parimin *in dubio pro reo*. Shpeshherë pretendohet se kur provat e njërit dëshmitar janë në kundërtënie me ato të dëshmitarit tjetër sa i përket faktit, atëherë ekziston dyshimi, dhe prandaj zbatimi i parimi *in dubio pro reo* duhet patjetër të gjejë versionin e fakteve në dobi të të pandehurit, duke çuar në lirim. Gjykata Supreme vëren se ky është një keqkuptim i parimit.


4.24. Parimi do të thotë se kur ekziston dyshimi në lidhje me **fajësinë** e të pandehurit, kjo duhet patjetër të zgjidhet në dobi të të pandehurit. I pandehuri nuk mund të shpallet fajtor nga gjykata kur dyshimi në lidhje me fajësinë e tij/saj vazhdon të ekzistoj. Kjo nuk e pengon trupin gjykues, si gjykues i fakteve, që të vlerësoj provat kontradiktore dhe të përfundojë se ata nuk kanë asnjë dyshim sa i përket gjetjeve të tyre.

4.25. Përmbajtja esenciale e parimit *in dubio pro reo* mund të ilustruhet me vendimin mbi ankesë i TPNJ⁵ në lëndën *Prokurori kundër Fatmir Limaj, Haradin Bala dhe Isak Musliu*⁶. Dhoma e apelit konsideron se parimi *in dubio pro reo*, si konkluzion i supozimit të pafajësisë dhe barrës së të provuarit përtej çdo dyshimi vlen për gjetjet e nevojshme për shpalljen fajtor, si ato që përbëjnë elementet e krimit të akuzuar. Parimi është esencialisht vetëm njëri aspekt i kushtit që fajësia duhet të vërtetohet përtej çdo dyshimi. Më tutje, parimi *in dubio pro reo* nuk zbatohet për provat individuale dhe gjetjes së fakteve mbi të cilat aktgjykimi nuk mbështetet.⁷

⁵ Tribunali ndërkombëtar për ndjekjen e personave përgjegjës për shkelje të rëndë të së Drejtës Njerëzore të kryer në territorin e ish Jugosllavisë prej vitit 1991

⁶ *Prokurori kundër Fatmir Limaj, Haradin Bala, Isak Musliu*, IT-03-66-A, aktgjykim, 27 shtator 2017

⁷ Shih faqe 11 të aktgjykimit IT-03-66-A.



4.26. Pretendimi i paraqitur në kërkesë është i pabazuar. Gjykata Supreme është e mendimit se nuk ka pasur shkelje të parimit *in dubio pro reo*.

F. Llogaritja e kohës së kaluar në paraburgim

4.27. Avokatët mbrojtës për B [REDACTED] S [REDACTED] dhe S [REDACTED] S [REDACTED] kanë ngritur çështjen e llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Gjykata Supreme ka vërejtur ndryshimin në dispozitiv nga Gjykata e Apelit në lidhje me këtë pikë. Gjykata Supreme pajtohet se nuk është e qartë, dhe ka shqyrtuar historinë e procedurës siç është detajuar nga Gjykata e Qarkut.

4.28. Sa i përket S [REDACTED] A [REDACTED] B [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] S [REDACTED] dhe S [REDACTED] U [REDACTED], është e qartë se masa e arrestit shtëpiak është caktuar më 28 korrik 2011 dhe është vazhduar gjatë gjithë procedurës, dhe prandaj si duket atyre duhet t'ju llogaritet kjo kohë. Avokati mbrojtës H [REDACTED] M [REDACTED] në emër të S [REDACTED] S [REDACTED] ka kërkuar që t'i llogaritet kjo periudhë. Sidoqoftë, është vërejtur gjatë seancës së Gjykatës së Apelit më 12 dhjetor 2013 se ai kishte vuajtur 4 muaj dënim me burgim në burgun e Dubravës, dhe kishte edhe 2 muaj për të vuajtur, edhe pse kjo informatë nuk është ofruar as nga i pandehuri e as nga mbrojtësi i tij. Prandaj, ky i pandehur nuk ishte duke vuajtur masën e arrestit shtëpiak pasi që ishte në vuajtje të dënimit me burgim, dhe koha të cilën e ka kaluar në vuajtje të atij dënimi me burgim nuk mund gjithashtu të llogaritet në drejtim të dënimit me burgim në këtë lëndë. Ngjashëm, Prokurorja e Shtetit vëren në përgjigjen e saj ndaj kërkesës së paraqitur nga avokati mbrojtës për B [REDACTED] S [REDACTED] se ai nuk ishte më në dispozicion për Gjykatën e Qarkut së paku që prej 17 dhjetori 2012. Prokurorja e Shtetit thekson se S [REDACTED] U [REDACTED] nuk është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor më 17 dhjetor 2012, por Gjykata Supreme nuk mund të gjej informata të mëtutjeshme nëse ka pasur ndonjë sqarim për mungesën e tij, apo nëse nuk ka respektuar arrestin shtëpiak.

4.29. Situata në lidhje me D [REDACTED] H [REDACTED] është edhe më e ndërlikuar. Si duket atij i është caktuar arresti shtëpiak prej 13 janarit 2010, dhe më 5 janar 2010 arresti shtëpiak i është ndërprerë dhe në vend të saj i është caktuar masa e paraburgimit. Më 12 shkurt 2010, i është ndërprerë paraburgimi dhe përsëri i është caktuar arresti shtëpiak. Më 1 tetor 2012, gjykata ka lëshuar urdhrin për arrestimin e tij për shkak të mosrespektimit të masës së arrestit shtëpiak, dhe më 10 tetor 2012, ai është arrestuar dhe përsëri i është caktuar paraburgimi. Më 14 nëntor 2012, paraburgim i është ndërprerë dhe arresti shtëpiak i është caktuar. Më 10 dhjetor 2012, ai përsëri nuk është gjetur në shtëpi dhe as nuk është paraqitur në shqyrtimin gjyqësor më 17 dhjetor 2012, dhe ka qenë në arrati deri më 5 mars 2014, sipas Prokurores së Shtetit. Nuk është e qartë se ku gjendet tani.

4.30. Pika e fundit në historinë e procedurës në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut thotë se më 22 janar 2013 arresti shtëpiak është vazhduar kundër S [REDACTED] A [REDACTED] dhe S [REDACTED] S [REDACTED] deri më 28 mars 2013.

4.31. Kolegji i Gjykatës Supreme është i mendimit se të pandehurve iu takon llogaritja e një periudhe në dënimet e tyre. Edhe pse Gjykata e Apelit nuk i ka llogaritur dhe shprehur kohën e saktë që duhet llogaritur, ka theksuar se koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet. Ky deklaram përfshinë edhe paraburgimin edhe arrestin shtëpiak. Siç është theksuar më lartë, nuk është fare e qartë cilat periudha të paraburgimit janë vuajtur nga secili i pandehur, dhe prandaj për Gjykatën Supreme nuk është e mundur që të bëjë llogaritje të sakta. Prandaj, një vendim në lidhje me këtë pikë duket të lëshohet me anë të aktvendimit të veçantë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në pajtim me nenin 489 të KPP-së. Kjo është procedura e drejtë kur paraqitet dyshimi në lidhje me llogaritjen e dënimit dhe avokatët mbrojtës duhet të paraqesin kërkesë në Gjykatën e Qarkut.

4.31. Gjykata Supreme është e mendimit se nuk ka pasur asnjë shkelje të dispozitave të ligjit penal në lidhje me çështjen e llogaritjes së kohës së kaluar në paraburgim.

G. Pretendimet tjera

4.31. Një numër i kundërshtimeve mbi bazat tjera mund të trajtohen shkurtimisht. Çështja e konfidencialitetit dhe dëshmitarit të privilegjuar K. V. nuk ka asnjë rëndësi pasi që është e qartë se këto çështje nuk kanë pasur peshë në marrjen e aktgjyqimit të ligjshëm nga Gjykata e Qarkut.

4.32. Gjykata e Apelit në mënyrë të qartë ka adresuar faktin se përshkrimi i një akti si i 'organizuar mirë' nuk do të thotë apo supozon se cilësimi juridik i veprës penale është ndryshuar në atë të Krimit të organizuar.

4.33. Pretendimet për ashpërsinë e dënimeve nuk paraqesin asnjë arsye për kolegjin që të konsiderojë se ka pasur ndonjë shkelje të ligjit penal.

4.34. Përfundimisht, Gjykata Supreme nuk sheh asnjë arsye që të diskutojë më tutje pretendimet tjera të paraqitura në kërkesa sepse ato janë qartazi të pretendime të pabazuara kundër gjetjeve të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës së Apelit, dhe në pjesën më të madhe tashmë të përmendura në aktgjyqime.

H. Përfundim

Kërkesat duhet patjetër të refuzohen.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.



Kryetar i kolegjit

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e kolegjit

Willem Brouwer
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse

Kerry Kirsten Moyes
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
GJYKATËSINË E KOPJËS E VERTEJON
PRAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Dyfishçeni radnik

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës:

Pml.Kzz 98/2014

(P. Nr. 592/2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë)

(PAKR 102/2013 Gjykata e Apelit)

Data:

9 janar 2015

Gjyqtari i EULEX-it Timo Vuojolahti si kryetar i kolegjit, në lëndën penale kundër:


S. A., i lindur më [redacted] në [redacted], i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LP KSAK) në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

D. H., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, i dënuar me shtatë (7) vjet burgim;

B. S., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të KPK-së, i dënuar me dymbëdhjetë (12) vjet burgim;

S. S., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës për vepër penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, i dënuar me tetë (8) vjet burgim;

S. U., i lindur më [redacted] në [redacted] i biri i [redacted] shtetas i Kosovës, i dënuar për vepër penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerjeje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 22 të KPRSFJ-së, tani e



dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (3), (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (3) dhe (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 23 të KPK-së, për veprë penale të vrasjes së rëndë në tentativë në bashkëkryerje nga neni 30 (1) dhe (2) i LP KSAK-së në lidhje me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së, tani e dënueshme sipas nenit 146 dhe 147 (5) dhe/ose (11) (cilësimi juridik i nenit 147 i ndryshuar në nenin 147 (5) nga ana e Gjykatës së Apelit), dhe sipas nenit 20 dhe 23 të KPK-së, dhe i dënuar me dënim unik me pesëmbëdhjetë (15) vjet burgim;

duke vepruar sipas Kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura nga avokati mbrojtës N. Q. në 30 prill 2014 në emër të të pandehurit S. A. nga avokati mbrojtës R. K. më 5 qershor 2014 në emër të të pandehurit D. H. nga avokati mbrojtës A. B. më 15 maj 2014 në emër të të pandehurit B. S. nga avokati mbrojtës H. M. më 11 qershor 2014 në emër të të pandehurit S. S. nga avokatët mbrojtës F. G. B. dhe B. J. më 2 qershor 2014 në emër të të pandehurit S. U., kundër aktgjyqimit të (ish) Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në këtë lëndë më datë 17 dhjetor 2012 dhe kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të datës 12 dhjetor 2013;

Duke vepruar sipas propozimit të avokatit mbrojtës R. K. në emër të të pandehurit D. H. të datës 15 dhjetor 2014, në përputhje me nenin 371 paragrafin 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPK)

lëshon këtë:

AKTVENDIM

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pml.Kzz 98/2014 i datës 3 shtator 2014 korrigohet ashtu që fjalia e dytë e paragrafit 4.29 në gjuhën shqipe është:

‘Duket se ndaj tij është caktuar masa e arrestit shtëpiak prej datës 13 janar 2010, dhe më 15 janar 2010 arresti shtëpiak është ndërprerë dhe është zëvendësuar me masën e paraburgimit.’

ARSYETIMI

Kjo fjali në versionin e aktgjyqimit në gjuhën angleze është e saktë. Gjatë përkthimit të aktgjyqimit në gjuhën shqipe data ‘15 janar 2010’ është përkthyer gabimisht si ‘5 janar 2010’.

Ky aktvendim bashkë me aktgjykimin me shkrim do t’u dorëzohet palëve.

Kryetar i kolegjit

Procesmbajtës

Timo Vuojolahti
Gjyqtar i EULEX-it

Kerry Kirsten Moyes
Zyrtare ligjore e EULEX-it



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
KURIA SUPREME E KOSOVES
VENDOSJA E DREJTISES
OST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašteni radnik